



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 290 Dt. 25.04.2023
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Në bazë të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), si dhe në bazë të Vendimit të Komisionit Arbitrar të FBK-së të datës 13.04.2023, Komisioni Disiplinor i FBK-së, me datë 25.04.2023 merr këtë:

VENDIM

- I. RISHQYRTOHET Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 08.03.2023;
- II. SHQIPTOHET dënim me ndalesë për kryerje të detyrës për të gjitha ndeshjet në kuadër të garave të FBK-së për periudhën kohore prej 18 muaj për z. Endrit Basha.

ARSYETIM

Me datë 10.03.2023, Komisioni Arbitrar i FBK-së pranoi Ankesën nga z. Basha në Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 08.03.2023. Komisioni Arbitrar i FBK-së shpalli të pranueshme Ankesën e z. Endrit Basha, vendosi për anulimin e Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 08.03.2023, ktheu në rivendosje po të njëjtin Vendim, duke detyruar Komisionin Disiplinor të ri-shqyrtojë lëndën në përputhje me udhëzimet e cekura në Vendimin e Komisionit Arbitrar të datës 13.04.2023.

Në këtë kuadër, KD ka mbajtur takim më 25.04.2023. Në takim kanë qenë prezent anëtarët e KD: Omer Daku (Kryetar), Armend Hamiti (Anëtar), Blerim Vuniqi (Anëtar), si dhe në përputhshmëri me nenin 37 të Rregullores Disiplinore, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së dhe Këshilltarja Ligjore për Sport e FBK-së.

Duke marrë parasysh udhëzimet e Komisionit Arbitrar, u shqyrtuan provat dhe dokumentet në dispozicion, dhe u konstatua si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

Fillimisht, sa i përket konstatimit për shkelje procedurale në Vendimin paraprak, Komisioni Disiplinor ka kuruar këtë shkelje dhe ka pranuar deklaratë me shkrim nga z. Basha më 18.04.2023. Për më tepër, Komisioni Disiplinor ka pranuar deklaratë edhe nga dy gjyqtarët e ndeshjes mes KBF Peja 03 dhe WBC Bashkimi së Xhiros IX Liga e Parë Femrat të zhvilluar me datë 26.02.2023 në Pejë.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Ndërsa sa i përket aspektit të së drejtës materiale, Komisioni Arbitrar ka vlerësuar se baza juridike e përdorur në Vendimin e parë nuk ka qenë e duhur, pasi që në rastin konkret nuk ka pasur mos-zbatim të vendimit për mos-kryerje të detyrës, por shkelje tjetër të ndëshkueshme me Rregulloren Disiplinore të FBK-së. Veç kësaj, Komisioni Arbitrar ka udhëzuar të mblidhen fakte dhe të konfirmohet nëse z. Basha mban pozitë zyrtare në klub, sepse në bazë të Rregullores Disiplinore kompetenca për dënime i përket organeve të FBK-së vetëm ndaj klubeve dhe personave zyrtarë të klubeve. Mbi këtë të fundit, Komisioni Disiplinor ka siguruar Fletëparaqitjen për edicionin 2022/2023, ku z. Basha figuron si person zyrtar i KBF Peja 03, gjegjësisht si Drejtor i klubit.

Bazuar në Nenin 65 të Rregullores Disiplinore të FBK-së, *'kush fyen, provokon ose fizikisht sulmon garuesin, trajnerin, gjyqtarin, funksionarin, delegatin ose shikuesin në lojë, ose jashtë terrenit të basketbollit: do të dënohet më së paku 6 muaj me ndalesë loje apo kryerje të detyrës'*. Bazuar në video-incizimin, anëtarët e Komisionit Disiplinor vlerësojnë se z. Basha, sipas gjuhës trupore dhe afërsisë ndaj gjyqtarëve, ka provokuar gjyqtarët. Kjo mbështetet edhe nga deklaratat nga gjyqtarët e ndeshjes, të cilët deklarojnë se z. Basha edhe i ka fyer gjatë tërë ndeshjes. Rrjedhimisht, dënimi minimal prej 6 muajsh është i zbatueshëm.

Ndërkaq, konform Nenit 23 dhe 25 të Rregullores Disiplinore, Komisioni Disiplinor merr parasysh rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese.

Siç edhe është cekur në Vendimin e shkallës së parë, Z. Basha veçse mban dënim mandatar të mëhershëm nga organet e FBK-së, dhe kjo vlerësohet si rrethanë rënduese. Për më tepër, deklarata e dërguar nga z. Basha me datë 18.04.2023 tenton të vë në lajthitje anëtarët e Komisionit Disiplinor. Z. Basha deklaron se nuk mund të konsiderohet si recidivist pasi që ai nuk mban asnjë pozitë zyrtare në Bordin e klubit apo në klub. Ndërkaq, në Fletëparaqitjen për edicionin 2022/2023 z. Basha mban pozitën e Drejtorit në klub. Veç kësaj, z. Basha poashtu deklaron se aktualisht nuk mban asnjë pozitë zyrtare në klub, mirëpo Lista e Personave Zyrtarë për ndeshjen mes KBF Peja 03 dhe KBF Bashkimi të datës 18.04.2023 paraqet z. Basha si ndihmës-trajner i klubit.

Në anën tjetër, si rrethanë lehtësuese është marrë fakti se z. Basha ka përvojë dhe është kontribut-dhënës në zhvillimin basketbollit të femrave në Pejë.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Prandaj, bazuar në këto rrethana rënduese dhe lehtësuese, z. Basha dënohet me 18 muaj ndalesë për kryerjen e të gjitha detyrave, për të gjitha ndeshjet në kuadër të garave të FBK-së.

Dënimi i lartcekur, në mendim të Komisionit Disiplinor, përçon qartë tek z. Basha se veprimet e paraqitura në video-incizimin janë tejet problematike dhe të pa tolerueshme, posaçërisht duke marrë parasysh se ky i fundit veçse ka qenë duke mbajtur dënim të shqiptuar nga organet e FBK-së, dhe se konform Nenit 20 të Rregullores Disiplinore, 'në rast se kryerësi pas dënimit të dytë kryen kundërvajtje të re, mund ti shqiptohet dënimi i ndalesës së përjetshme për loje ose kryerje të detyrës.'

Rrjedhimisht, duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Armend Hamiti
Anëtar

KOMISIONI DISIPLINOR :

Omer Daku
Kryetar

Blerim Vuniqi
Anëtar



Vendimi i dërgohet:

- z. Endrit Basha (KBF Peja 03)
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së
- Komisionit të Garave
- Komesarit të Garave dhe Komesarit të Garave për Kategoritë e Reja
- Arkivit të FBK-së

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA


Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

KËSHILLË JURIDIKE: Konform Nenit 43 të Rregullores Disiplinore, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrahet ankesë në afat prej 3 ditësh, duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit, kurse i paraqitet Komisionit Arbitrar. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën në shumën prej 300 €, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

